



REPUBLICA E KOSOVËS
REPUBLICA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E OBILIQIT
OPŠTINA OBILIĆ - MUNICIPALITY OF OBILIC



KUVENDI KOMUNAL OBILIQ
Skupština Opštine Obilić - Municipality Assembly Obiliq

EKSTRAKT I PROCESVERBALIT

Nga mbledhja e Komitetit për Politikë dhe Financa, të mbajtur me dt.23.07.2024, në ora 11:00, në sallën e Kuvendit komunal.

Të pranishëm ishin: Vlora Mjekiqi Kabashi, Enver Gashi, Sami Ahmeti, Bajram Hashani, Labinot Mirena dhe Nazlije Shala

Të pranishmit tjerë: Festina Preniqi, zyrtare për marrëdhënie me publikun dhe përf, e KFOR-it

Mbledhjen e udhëhoqi Vlora Mjekiqi Kabashi, kryesuese e Komitetit e cila pasi konstatoi se ka kuorum filloi mbledhjen me këtë:

REND DITE

1. Arsyetimi për mungesë
2. Miratimi i ekstraktit të procesverbalit nga mbledhja e kaluar
3. Raporti gjashtëmuor (6) i punës së Kryetarit të Komunës dhe Ekzekutivit për vitin 2024
4. Raporti financiar i shpenzimeve Janar – Qershor 2024
5. Shqyrtimi i kërkesës së DKRS-së, për plotësim-ndryshimin e Statutit të Ansambllit të Qytetit
6. Raporti i Auditimit të Performancës
7. Raporti i Auditimit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Obiliqit për vitin 2023
8. Shqyrtimi i kërkesave
9. Të ndryshme

Kryesuesja – I njoftoi të pranishmit me rendin e ditës, i cili u miratua me 6 vota për.

Pika 1 e rendit të ditës

Kryesuesja – Ju njoftoj se anëtarja e Kuvendit Komunal njëherit edhe e këtij Komiteti Ajshe Haliti Pllana ka dhënë dorëheqje për arsye të punësimit në shërbimin civil dhe presim anëtarin e radhës sipas listës nga subjekti politik i LVV-së, që të japë betimin në seancën e Kuvendit. Po ashtu, presim edhe propozimin se kush do të jetë anëtarë e Komitetit për Politikë dhe Financa në të ardhmen. Të pranishëm në mbledhje janë 6 anëtarë.

Pika 2 e rendit të ditës

Miratohet ekstrakti i procesverbalit nga mbledhja e kaluar me 6 vota për.

Pika 3 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti kërkesën e Kryetarit të Komunës për raportin gjashtëmuor të punës së Kryetarit dhe Ekzekutivit për vitin 2024.

Enver Gashi – Raporti i punës së Kryetarit dhe Ekzekutivit është dërguar me kohë dhe ne jemi për që ky raport të shkoj për shqyrtim në seancë të Kuvendit Komunal.

Sami Ahmeti – Si raport ne jemi për atë që të shkoj në seancën e Kuvendit Komunal dhe nëse, kemi diçka do të debatojmë në seancë.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 6 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin e Raportit gjashtë mujor të punës së Kryetarit të Komunës dhe Ekzekutivit për vitin 2024.

Pika 4 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti kërkesën e DEFZH-së, për raportin financiar të shpenzimeve janar-qershor 2024.

Enver Gashi – Edhe për këtë pikë jemi dakord që ky raport financiar të shkoj në Kuvend dhe atje, do ta japim kontributin tonë.

Sami Ahmeti – Gjithashtu, edhe ne jemi dakord.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa me 6 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin e Raportit financiar të shpenzimeve janar-qershor 2024.

Pika 5 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti kërkesën e DKRS-së, për plotësim-ndryshimin e Statutit të Ansambllit të Qytetit.

Enver Gashi – Ne jemi për atë që ky dokument të shkoj në seancën e Kuvendit Komunal.

Sami Ahmeti – Edhe ne jemi dakord.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 6 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin dhe aprovimin e kërkesës së DKRS-së, për plotësim-ndryshimin e Statutit të Ansambllit të Qytetit.

Pika 6 e rendit të ditës

Kryesuesi – Juve, iu ka ardhë si material edhe Raporti i Auditimit të Performancës dhe nëse, keni diçka me thënë lidhur me këtë çështje, apo e rekomandojmë për Kuvend.

Enver Gashi – Ne jemi për atë që Raporti i Auditimit të Performancës ti rekomandohet Kuvendit Komunal.

Sami Ahmeti – Po, gjithsesi është një dokument obligativ që të trajtohet në seancë dhe ne e mirëpresim që të jetë në seancën e Kuvendit Komunal. Ajo që kërkojmë ne është që nëse, kemi ndonjë pyetje në seancë të Kuvendit të jetë dikush të iu përgjegjet atyre pyetjeve.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 6 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal për shqyrtim Raportin e Auditimit të Performancës.

Pika 7 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti Raportin e Auditorit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Obiliqit për vitin 2023.

Enver Gashi – Edhe për këtë pikë jemi për që të shkoj për shqyrtim në Kuvendin Komunal. Sa i përket pyetjeve dhe dhënies së përgjegjeve në seancë të Kuvendit, unë nuk kam hasë në ndonjë pyetje pa përgjegje sepse gjithmonë anëtarët i kanë marrë përgjegjet në Kuvend, ose ka mbetë që në mbledhjen e ardhshme ti marrin përgjegjet për pyetjet e bëra.

Sami Ahmeti – Sa i përket pikës së rendit të ditës jemi pro sepse është vazhdimësi e pikës paraprake ndërsa, sa i përket pikës së parafolësit kisha pasë dëshirë me folë në të ndryshme.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 6 vota për ia rekomanduan Kuvendit Komunal shqyrtimin e Raportit të Auditorit për pasqyrat financiare vjetore të Komunës së Obiliqit për vitin 2023.

Pika 8 e rendit të ditës

Kryesuesja – Paraqiti kërkesën nga Nasuf Hoxha, lidhur me disa lokale dhe propozoi që kjo kërkesë ti rekomandohet DPUKP-së, për shqyrtim.

Anëtarët e Komitetit për Politikë dhe Financa, me 6 vota për kërkesën nga Nasuf Hoxha ia rekomanduan për shqyrtim DPUKP-së.

Pika 9 e rendit të ditës

Kryesuesja – Siç ju thashë në fillim meqë, ende nuk e ka dhënë betimin anëtarja që vjen sipas radhës nga subjekti i LVV-së, ne presim në të ardhmen e afërt sipas propozimit që të bëhet ndryshimi edhe në përbërjen e Komitetit për Politikë dhe Financa.

Sami Ahmeti – Duke u lidhë te fjala e z.Gashi, që tha se nuk ka hasë asnjëherë ndonjë pyetje pa përgjegje edhe unë e konfirmoj se shumica e pyetjeve që janë bërë kanë pasë përgjegje dhe a kanë qenë të plota, apo jo nuk ka rëndësi. Unë deshta me u ndërlidhë me një pikë që e kemi ngritë në mbledhjen e fundit të Komitetit për Politikë dhe Financa, procesverbalin e së cilës vetëm sa e miratuam. Në mbledhjen e fundit të Komitetit për Politikë dhe Financa, e kam ngritë një çështje në formën anglisht i thojnë polite të mundshme, më të sinqertë të mundshme çështjen e mykut në QKMF në Obiliq. Në momentin që ka mbaruar seanca, Enveri veç e tha për shkak të ndërtimeve nuk kam pasë më interesim me u marrë më me atë punë se e kuptoi një çështje të tillë. Më heret e pashë që drejtoresha e shëndetësisë ishte këtu, por edhe juve deshta me ju pyet sigurisht nëse, është edhe Kryetari në seancë a është në rregullë ju drejtorë me i kontestue pyetjet e Kuvendit Komunal, madje me i fye rëndë personat apo një subjekt politik, unë mendoj se është një shembull shumë i keq. Nëse, një person ne që jemi të thirrur për këto çështje e ngrisim një çështje unë të paktën mendoj se e kemi dëshmue që është njëri prej Kuvendeve, që kemi pasë më së pakti konflikte sepse për shumicën e gjërave në të mirë të qytetarëve jemi pajtue nga se në fund të fundit po jetojmë në ambientin e njejtë dhe kur janë gjërat e mira janë të mira, por kur janë të këqija janë të këqija, të paktën me dhënë një shpjegim. Ato shprehjet “brigadat e kuqe” “idiotët” “e di kush ju ka que” unë mendoj se është më e vogla sepse realisht ne kemi një kërkimfalje prej vetë personit, mirëpo kërkimfalja e tij ka que krejtë tjetërkah, “jam i obliguar me folë kështu sepse nuk më mban askush”. Mirëpo, kjo është pjesë e bisedave të brendshme. Mua më intereson me ditë prej drejtoreshës a distancohet prej kësaj deklarate sepse nëse, jo atëherë për çka ne funksionojmë, nuk jemi vetëm makina votuese. Unë me keqardhje e kam pritë këtë revansh të tillë sepse kam provue me qenë shumë bashkëpunues me juve.

Kryesuesja – Sa i përket Kuvendit Komunal, ne i kemi edhe dëshmitë edhe pse nuk e kemi obligim, por dojmë me i respektue anëtarët tonë të Kuvendit, në radhë të parë me i mbështetë anëtarët e Kuvendit sepse jam e thirrur për ju dhe me automatizëm bashkë me bashkëpunëtoren i përcjellim pyetjet e juaja te Drejtoritë përkatëse, që me ardhë me një përgjegje në Kuvend. E di që e kemi adresue te drejtoresha, por na u ka kthye me automatizëm sepse ka qenë në pushim. Doktorin e kam pyetë atë ditë në pikën të ndryshme tha se kam për me folë edhe për atë punë. Unë në pikën të ndryshme kam pyet a ka edhe dikush me folë, por nuk e di si u koklavit puna dhe ai nuk e mori fjalën, dikush më tha e ka ngritë dorën për me dhënë përgjegje, por nuk e di nuk e kam parë. Drejtoresha është këtu, nëse don me dhënë ndonjë përgjegje, apo mbetet në seancë të Kuvendit.


Blerona Shabanaj Mehmeti – Në seancë të Kuvendit do të japë përgjegje.

Sami Ahmeti – Unë ndaj drejtoreshës pata vetëm pyetje sepse tashmë është konsumue ajo temë, a distancohet prej këtij fjalori që ta di se a kemi nevojë me bë pyetje më ose jo sepse është gabim kryesuese nëse, thua se nuk e ke obligim. Obligim i yni nuk është vetëm me ardhë këtu dhe me votue si makina votuese, ne mund të ngrisim çështje aq më tepër sepse jemi përfaqësues të Komitetit për Politikë dhe Financa, do të thotë është obligative drejtorët me u përgjegjë, kështu e kuptova unë. Në këtë radhë unë kam pyetje direkte për drejtoreshën a distancohet prej një fjalori të tillë, apo jo.

Kryesuesja – Ju sqaroj, se nuk e kemi obligative për arsye se Drejtoritë, ose përfaqësuesit e tyre duhet të jenë në mbledhjen e KPF-së dhe të Kuvendit Komunal me ditë se çka po ndodhë dhe çka po flitet. Mua, disa herë ma ka thënë bashkëpunëtorja për punë të Kuvendit, se ne nuk e kemi obligim, por ne gjithmonë mbajmë shenime dhe pyetjet e juaja i përcjellim.

Mbledhja përfundoi në ora 11:20'

Bashk.prof.për punë të KK


Azize Zeneli


Kryesuese e KPF,

Vlora Mjekiqi Kabashi